

No. 45228*

**Romania
and
Albania**

Treaty between Romania and the Republic of Albania on understanding, cooperation and good-neighbourliness. Bucharest, 11 May 1994

Entry into force: *26 April 1995 by the exchange of instruments of ratification, in accordance with article 18*

Authentic texts: *Albanian and Romanian*

Registration with the Secretariat of the United Nations: *Romania, 8 September 2008*

**The texts reproduced below are the original texts of the agreement as submitted. For ease of reference, they were sequentially paginated. The relevant Treaty Series volume will be published in due course.*

**Roumanie
et
Albanie**

Traité d'entente, de coopération et de bon voisinage entre la Roumanie et la République d'Albanie. Bucarest, 11 mai 1994

Entrée en vigueur : *26 avril 1995 par échange des instruments de ratification, conformément à l'article 18*

Textes authentiques : *albanais et roumain*

Enregistrement auprès du Secrétariat des Nations Unies : *Roumanie, 8 septembre 2008*

**Les textes reproduit ci-dessous sont les textes authentiques de l'accord tel que soumises pour l'enregistrement. Pour référence, ils ont été présentés sous forme de la pagination consécutive. Le volume correspondant du Recueil des Traités sera disponible en temps utile.*

[ALBANIAN TEXT - TEXTE ALBANAIS]

T R A K T A T

MIREKUPITIMI, BASHKEPUNIMI DHE FQINJESISE SE MIRE
MIDIS RUMANISE DHE REPUBLIKES SE SHQIPERISE

Rumania dhe Republika e Shqiperise,

Nisur nga traditat e miqesise, bashkepunimit dhe fqinjesise se mire ne marredheniet midis tyre,

Te bindura nga domosdoshmeria e afrimit midis shteteve ne baze te vlerave te pergjithshme humane-njerezore te lirise, demokracise, pluralizmit, drejtësisë shoqerore dhe solidaritetit, te respektimit te te drejtave dhe lirive te njeriut,

Duke riafirmuar mbeshitetjen e tyre ndaj qellimeve dhe principeve te Kartes se OKB-se,

Te ndergjegjshme per rendesine e aktit Final te Helsinkit, te Kartes se Parisit per nje Evrope te re dhe te dokumenteve te tyre per sigurimin dhe bashkepunimin ne Evrope dhe duke ripohuar angazhimet e marra ne baze te tyre,

Te vendosura per forcimin e marredhenieve te ndersjellta te miqesise, bashkepunimit dhe fqinjesise se mire,

U moren vesh per sa me poshte;

NENI 1

Rumania dhe Republika e Shqiperise, me poshte te quajtura "Pale Kontraktuese" do te zhvillojne marredheniet e tyre mbi bazen e besimit, bashkepunimit dhe respektit reciprok ne perputhje me parimet e sovranitetit, integritetit territorial te te drejtave te barabarta solidaritetit dhe dinjitetit njerezor, te respektimit te lirive dhe te drejtave themelore te njeriut.

NENI 2

Te dy palet do te veprojne, ne frymen e "Kartes se Parisit" e per nje Evrope te Re" ne drejtim te transformimit te Evropes ne nje komunitet shtetesh, i cili ta perbere nje hapësirë te paqes se qendrushme, te te drejtes dhe te demokracise dhe ne kete

TR/080908 / I-45228

- 2 -

drejtim, per krijimin e disa mekanizmave efikase te sigurise dhe bashkepunimit ne kontinent.

Te dyja Palet Kontraktuese do te japin kontributin e tyre ne zhvillimin e bashkepunimit midis shteteve ballkanike; per forcimin e mirebesimit, paqes dhe stabilitetit ne Ballkan si dhe ne realizimin e disa projekteve zonale, si element te procesit te ndertimit te nje Evrope te Bashkuar.

NENI 3

Te dy Palet Kontraktuese riafirmojne papranueshmerine e perdorimit te forces dhe kercenimit nepernjehet forces ne marrredheniet nderkombetare dhe nevojen e zgjidhjes se te gjitha problemeve nderkombetare me mjete paqesore.

Ato do te veprojne per perdorimin e mjeteve per rregullimin paqesor te mosmarreshjeve te parashikuara ne Karten e OKB-se, si dhe te mekanizmave korresponduese.

Ne kontekstin Evropian, Palet Kontraktuese do te japin kontributin e tyre ne krijimin dhe funksionimin efikas te mekanizmave per zgjidhjen paqesore te mosmarreshjeve dhe parandalimin e konflikteve.

NENI 4

Ne qofte se njera nga palet do te konsideroje se lind nje situat e cila sjell prekjen e interesave te saj te larta te sigurimit, ajo mund t'i drejtohet pales tjetere, ne menyre qe ato te veprojne pa vonese me konsultime per kete problem.

NENI 5

Te dy Palet Kontraktuese do te veprojne, ne kuadrin e KSBE-se per realizimin e procesit te zvogelimit ne menyre te ekuilibruar te forcave ushtarake dhe armatimeve, per forcimin e besimit dhe qendrueshmerise ne kontinent.

Palet do te bashkepusojne ne te gjitha bisedimet nderkombetare ne te cilat marrin pjese te dyja, per arritjen e qarmatimit, nen nje kontroll te rrepte dhe efikas nderkombetar.

NENI 6

Palet Kontraktuese do te mbeshtesin zhvillimin dhe shumellojshmerine e marredhenievet ekonomike bilaterale te mbeshetura ne barazi, bashkepunim partneritet dhe perfitim te ndersjellte.

Ato do te veprojne per krijimin e hapesires ekonomike

- 3 -

evropiane, bazuar ne zhvillimin ekonomik optimal dhe permiresimin e gjendjes se secilit vend, ne zgjerimin e shkembimeve dhe bashkepunimit ne kontinent.

NENI 7

Palet Kontraktuese do ta shtrijne bashkepunimin per perfitim te ndersjellte ne fushat e industrise, bujqesise, shkences e teknikes per perdorimin me efikasitet te burimeve te tyre materiale e njerezore.

Ato do te favorizojne realizimin e shpejte te programeve te bashkepunimit dhe te shkembimeve ekzistuese nisur nga realiteti dhe interesat e te dy vendeve, si dhe te bien dakord sipas nevojave per marrjen e programeve te reja.

NENI 8

Palet Kontraktuese do te nxisin bashkepunimin e ngushte ne fushat te cilat kane nje rendesi te vegante per zhvillimin e ekonomive te tyre kombetare, e sidomos ne fushat e meposhtme:

- Zhvillimi i bazeve energjetike, lendeve djegese dhe lendeve te para, perdorimit te energjise berthamore per qellime paqesore;
- Zhvillimi i bujqesise;
- Transporteve dhe infrastruktures;
- Ndertime industriale dhe civile;
- Venia ne perdorim e burimeve natyrore per plotesimin reciprok te kerkesave ekonomike te tyre;
- Prodhimi i artikujve te konsumit te gjere.

NENI 9

Duke unisur nga karakteri i pergjithshem i problemeve te mbrojtjes se mjedisit rrethues, Palet Kontraktuese do te perpiqen te nxisin bashkepunimin e tyre ne kete fusha ne perputhje me angazhimet e marra ne kuadrin e marreveshjeve nderkombetare ku ato jane Pale.

Ne te njejten menyre ato do te bashkepusojne per parandalimin e ndotjes se mjedisit dhe sigurimin ekologjik ne Ballkan.

NENI 10

Palet Kontraktuese do te stimulojne bashkepunimin dhe lidhjet direkte ndermjet njesive ekonomike dhe subjekteve te

- 4 -

tjera ekonomike te dy vendeve.

Ato do te veprojne per permiresimin e kushteve te veprimtarise se njesive ekonomike dhe subjekteve ekonomike, ne menyre te vegante ne fushen e investimeve direkte, te mbrojtjes se investimeve te kapitalit dhe te eliminimit te taksimit te dyfishte.

Palet do te bashkepunojne per formimin e pergatitjen e specialisteve te kualifikuar per veprimtari ne fushat ekonomike dhe sociale.

Ato do te zhvillojne konsultime dhe do te mbeshtesin realizimin e programeve te bashkepunimit per probleme ekonomike e manaxheriale.

Ato do te stimulojne realizimin e programeve dhe projekteve te perbashketa, krijimin e shoqerive mikste, shkembimin e shkencetareve dhe studjuesve dhe forma tjera bashkepunimi, duke patur si qellim rritjen ne radhe te pare te nivelit te kompetences dhe efektivitetit te aktiviteteteve kerkimore.

NENI 11

Te dy Palet Kontraktuese, nisur nga traditat e vjetra te bashkepunimit dhe komunikimit kulturor ndermjet dy popujve te dy vendeve dhe duke dashur te kontribuojne ne krijimin e nje hapesire kulturore evropiane te hapur per te gjitha popujt e kontinentit do te favorizojne zhvillimin e shkembimeve ndermjet institucioneve, njesive administrative-territoriale, personave dhe organizatave joqeveritare te te dy vendeve ne fushat e kultures, arsimit dhe informacioneve.

Palet Kontraktuese do te mbeshtesin perfundimin e marreveshjeve direkte ndermjet universiteteve dhe institucioneve te arsimit te larte, qendrave kerkimore, institucioneve kulturore, te shperndarjes se informacioneve.

Ato do te inkurajojne iniciativat per bashkepunimin dhe shkembimin ne fushen e mjeteve audio-vizuale, kinematografise, teatrit, muzikes dhe arteve figurative.

Secila Pale Kontraktuese do te veproje per zgjerimin e mundesive te mesimit te gjuhes te palës tjetër ne shkolla, institute te arsimit te larte, per kete qellim Palet do te ndihmojne reciprokisht aksionin e studimit te gjuhes dhe te ngritjes se kualifikimit te profesoreve.

Ato do te perkrahin gjithashtu nismat per zgjerimin e mundesise se mesimit dhe te mesindhenies ne gjuhen e vendit tjetër, duke patur parasysh traditat ekzistuese ne kete fushë, per nje njohje me te mire reciproke.